

Liridon LIKA¹

STRATEGJIA E TURQISË PËRBALLË SHTETEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Abstrakt : Që nga ardhja në pushtet e Partisë për Drejtësi dhe Zhvillim (Adalet ve Kalkinma Partisi, AKP) në vitin 2002, Turqia, ashtu sikurse fuqitë e tjera emergjente, nuk ngurron të ndjek një politikë të mbështetur në diversifikimin e marrëdhënieve të saj të jashtme me qëllim që të luaj një rol më të madh në skenën ndërkombëtare. Qeveria turke ka miratuar kështu një politikë të jashtme të quajtur « zero probleme » me shtetet fqinjë ku përfshihen edhe ato të Ballkanit Perëndimor. Nëpërmjet një politike të tillë, autoritetet turke po bëjnë përpjekje të rikthejnë ndikimin e tyre në këtë hapësirë e cila për pesë shekuj me radhë ishte pjesë përbërëse e Perandorisë Osmane. Megjithatë, rrethanat e tanishme në Ballkan janë krejtësisht të ndryshme krahasuar me ato të një shekulli më parë. Prandaj, ambiciet proaktive të politikës së jashtme turke për një dominim klasik të rajonit ngjajnë të jenë në mospërputhje me kohën.

Abstract: Since coming to power of the Justice and Development Party (Adalet ve Kalkinma Partisi, AKP) in 2002, Turkey, like other emerging powers, does not hesitate to pursue a policy based on diversification of its external relations in order to play a greater role on the international scene. The Turkish government has adopted a foreign policy so called "zero problems" with neighboring countries including the Western Balkans. Through such a policy, the Turkish authorities are making efforts to regain influence in this area, which for five centuries was part of the Ottoman Empire. However, current circumstances in the Balkans are totally different compared to those of a century ago. Therefore, proactive ambitions of Turkish foreign policy for a classic domination of the region appear to be inconsistent with the time.

Hyrje

Me rënien e murit të Berlinit që shënon edhe fundin e luftës së ftohtë, nëpër botë filluan të shfaqen akterë të ndryshëm duke vënë kështu në pikëpyetje hegjemoninë disa shekullore të botës perëndimore. Në grupin e këtyre akterëve që njihen me emrin « fuqi emergjente » bëjnë pjesë Afrika e Jugut, Brazili, India, Kina, Rusia por gjithashtu edhe vende të tjera sikurse Indonezia, Meksika apo Koreja e Jugut, të cilat kohët e fundit, çdo ditë e më shumë, po zënë një pozitë të rëndësishme në skenën ndërkombëtare. Në fakt, akterët emergjent, të cilët përbëjnë pra disa pole tërheqëse, janë duke njohur një rritje ekonomike shumë të shpejtë e cila po ua mundëson të përafërohen me vendet më të pasura të planetit.

Që nga ardhja në pushtet e AKP-së në vitin 2002, edhe Turqia është gjithashtu duke njohur një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe në të njëjtën kohë

¹ Asistent dhe kandidat për doktoraturë në Qendrën për Studime të Marrëdhënieve Ndërkombëtare pranë Departamentit të Shkencave Politike të Univerzitetit të Liezhit (Belgjikë)

ka bërë një ndryshim thelbësor në politikën e saj të jashtme me synimin që të përforcoj rolin e saj në botë. Zvarritjet e Bashkimit Europian (BE) për sa i përket pranimin të shtetit turk në gjirin e tij duket të kenë përforcuar bindjen e Ankarasë që të hapet ndaj vendeve tjera të botës. Kjo e fundit ka vënë në punë kështu një strategji të shumëfishimit të mardhënieve të saj me shtete të ndryshme në të gjitha kontinentet, mirëpo një përparësi e veçantë i është dhënë hapësirës gjeografike më të afërt përmes parimit « zero probleme » me fqinjët, ku bëjnë pjesë edhe shtetet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë mënyrë, Turqia, e cila po zhvillon një politikë të pavarurë në rrafshin ndërkombëtar, është bërë kështu objekt studimi i shumë specialistëve të mardhënieve ndërkombëtare. Ky punim ka për synim të sjellë pikërisht një analizë të politikës së jashtme turke përballë shteteve të Ballkanit Perëndimor. Më saktësisht, t'i përgjigjet pyetjes kërkimore se çfarë ndikimi ka Turqia në këtë hapësirë ?

Pjesa e parë e këtij artikulli i kushtohet aspektit teorik në të cilin mbështet ky studim, domethënë konceptit që përcakton Turqinë si fuqi emergjente. Pastaj, në pjesën e dytë, do të shtjellohet politika e jashtme turke përballë shteteve të Ballkanit Perëndimor. Së fundi, në pjesën e tretë, analiza përqendrohet veçanërisht mbi pengesat e shtetit turk për të rritur ndikimin e tij në këtë rajon.

1. Turqia, një fuqi emergjente në rajon

Viteve të fundit, në mjediset diplomatike, financiare, mediatike dhe akademike, shprehja “fuqi emergjente” ka zënë një vend të posaçëm. Kjo terminologji për herë të parë është përdorur në fushën e ekonomisë dhe përfshinte « tregjet në zhvillim » për dallim nga dy kategoritë e tjera, përkatësisht ajo e vendeve të zhvilluara dhe e atyre të varfëra¹. Prandaj, një shprehje e tillë, përgjithësisht, nënkupton “vendet në zhvillim që kanë përjetuar një rritje ekonomike më të lartë se mesatarja, për një kohë të gjatë të mjaftueshme për të rritur të ardhurat për kokë banori në mënyrë të qëndrueshme”².

Mirëpo, sikurse në ekonomi ashtu edhe në fushën e mardhënieve ndërkombëtare shprehja fuqi emergjente përmban në vetvete një lloj mjegullimi apo paqartësie. Siç shprehet S. Santander, edhe pse “në pamundësi për të sjellur një përkufizim të saktë të këtij koncepti, ky mbulon një realitet të veçantë, atë të shpërndarjes së fuqisë botërore, dhe, për pasojë, të një vënie në pikëpyetje progresive të monopolit të fuqisë së mbajtur për pesë shekuj nga bota perëndimore”³. Sidoqoftë, edhe pse mungon një definicion i saktë, një gjë është e sigurtë, në ditët e sotme akterët emergjentë janë shumë të pranishëm në skenën ndërkombëtare. Këta të fundit janë fuqi të mëdha territoriale, demografike, ekonomike, teknologjike por edhe gjeopolitike. Autorë të ndryshëm argumentojnë se

¹ Christophe JAFFRELOT, « Introduction », in *L'enjeu mondial. Les pays émergents*, sous la direction de Christophe JAFFRELOT, Paris, Presses de Sciences Po - L'Express, 2008, faqe 13.

² Alexandre KATEB, *Les nouvelles puissances mondiales. Pourquoi les BRIC changent le monde ?*, Paris, Ellipses Edition Marketing S.A., 2011, faqe 12.

³ Sebastian SANTANDER, « Les puissances émergentes, l'Europe et le monde », in *Puissances émergentes : un défi pour l'Europe ?*, sous la direction de Sebastian SANTANDER, Paris, Ellipses Edition Marketing, 2012, faqe 10.

edhe Turqia posedon pothuajse të gjitha këto karakteristika të cilat e kanë shndërruar atë tashmë në një fuqi emergjente rajonale¹.

Në të vërtetë, koncepti i fuqisë ka qenë objekt i studimeve të shumta në marrëdhëniet ndërkombëtare ku secila teori ka sjellur një perspektivë të ndryshme. E lidhur shpesh me idealizëm, shkolla liberale argumenton se është e mundur të arrihet paqja botërore midis shteteve dhe të shkohet përtej logjikës së konkurrencës anarkike të imponuar nga fuqia. Megjithatë, autorët e shkollës realiste e kundërshtojnë këtë pikëpamje duke deklaruar se duhet kuptuar botën ashtu siç është dhe jo si ne do të dëshironim që ajo të jetë. Frymëzuar nga reflektimet klasike të Makiavelit dhe Hobsit, teoricienët e rrymës realiste shpjegojnë se koncepti i fuqisë është elementi qendror që udhëzon shqetësimet e shtetit². Sipas kësaj teorie, shtetet në mardhëniet me të tjerët kanë vetëm një synim dhe ai është i lidhur ngushtë me rritjen në maksimum të fuqisë së tyre³. Për këtë shkollë të mendimit, "politikat e fuqisë praktikohen nga të gjithë për dy arsye që ndërlidhen, në njëërën anë me natyrën njerëzore, dhe në tjetërën me anarkinë e sistemit ndërkombëtar"⁴. Ky lloj përkufizimi konsideron se interesi kombëtar i një shteti është egoist në raport me interesat kombëtare të shteteve tjera. Thënë ndryshe, secili shtet synon pra që të mbrojë interesat e veta dhe njëkohësisht të rrisë sa më shumë fuqinë e tij përballë shteteve tjera në rrafshin ndërkombëtar në të cilin mbretëron pasiguria⁵. Ndërsa sipas J. Nye, fuqia tregon aftësinë e një shteti për të arritur rezultatet e dëshiruara dhe nëse paraqitet nevoja duke ndryshuar edhe sjelljet e të tjerëve për t'a përmbushur qëllimin e tij⁶. Në analizën e fuqisë së një akteri, Nye përdor dy nocione: atë të fuqisë së fortë (*hard power*) e cila bazohet në faktorët ushtarakë dhe ekonomikë, dhe të fuqisë së butë (*soft power*) që konsiderohet si një mjet i tërthortë i ndikimit ose si një aftësi joshëse e një vendi për të arritur objektivat e veta, pa përdorimin e forcës, por përmes burimeve jomateriale të tilla si imazhi pozitiv, vlerat dhe kultura. Sipas Nye, fuqia pra përbëhet prej faktorëve të prekshëm (material/sasiorë) dhe të paprekshëm (jo-material/jo-sasiorë). Faktorët materialë nënkuptojnë: popullsinë, territorin, burimet natyrore, fuqinë ekonomike apo forcat ushtarake, ndërsa ata jo-material, përfshijnë ngjizjen kombëtare, ideologjinë, kulturën dhe ndikimin në institucionet ndërkombëtare⁷. Por për të plotësuar përkufizimin e konceptit të fuqisë, përfaqësimi dhe njohja e akterit nga të tjerët duhet gjithashtu të merren parasysh⁸.

¹ Marcel BAZIN et Stéphane de TAPIA, *La Turquie. Géographie d'une puissance émergente*, Paris, Éditions Armand Colin, 2012, faqe 296-298.

² Mario TELÒ, *Relations internationales : Une perspective européenne*, Bruxelles, Institut d'études européennes, Édition de l'Université de Bruxelles, Deuxième édition revue et augmentée, 2010, faqe 27-29.

³ John MEARSHEIMER, *The Tragedy of Great Power Politics*, London; New York, NY: W.W. Norton, 2001, faqe 5.

⁴ Stefano GUZZINI et Sten RYNNING, « Réalisme et analyse de la politique étrangère », in *Politique étrangère. Nouveaux regards*, sous la direction de Frédéric CHARILLON, Paris, Presses de Sc. Po, 2002, faqe 33.

⁵ Dario BATTISTELLA, « Chapitre 5 : L'intérêt national. Une notion, trois discours », in *Politique étrangère. Nouveaux regards*, sous la direction de Frédéric CHARILLON, Paris, Presses de Sc. Po, 2002, faqe 144-145.

⁶ Joseph S. NYE JR, *The Paradox of American Power*, New York, Oxford University Press, 2002, faqe 4.

⁷ *Ibid.*, faqe 4-9.

⁸ Sebastian SANTANDER, « Ordre mondial, hégémonie et puissances émergentes », in *L'émergence des nouvelles puissances : vers un système multipolaire?*, sous la direction de Sebastian SANTANDER, Paris, Ellipses Édition, Marketing, 2009, faqe 24.

Miratimi i politikave të frymëzuara në përgjithësi nga koncepti i fuqisë së butë, por së fundi edhe nga ai i fuqisë së fortë sidomos në rastin e luftës në Siri, i ka lejuar shtetit turk që të fitoj një pozitë më të rëndësishme në skenën ndërkombëtare. Duke u bazuar në një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të këtyre dhjetë viteve të fundit, sikurse qeveritë e fuqive emergjente si Kina, India apo Brazili, edhe qeveria turke ka përpiluar një politikë ambicioze si në rrafshin rajonal ashtu edhe në atë ndërkombëtar me qëllim që të shumëfishoj partnerët e saj politikë dhe ekonomikë rreth e rrotull globit. Për t'u afirmuar si një lider rajonal, Ankaraja ka bërë kështu një ndryshim rrënjësor në politikën e saj të jashtme përmes themelimit të një strategjie gjithëpërfshirëse, shumëdimensionale dhe proaktive, të quajtur "zero probleme" me të gjitha vendet fqinjë ku përfshihen edhe shtetet e Ballkanit Perëndimor¹.

2. Ballkani Perëndimor në politikën e jashtme turke

Në doktrinën e re turke që rrjedhë nga AKP-ja, përveç interesave të mëdha në Azinë Qendrore, Kaukaz, apo Afrikë, edhe rajoni i Ballkanit Perëndimor shfaqet gjithashtu si një territor me rëndësi parësore. Duke pasur parasysh që ky territor ka qenë për pesë shekuj me radhë pjesë e Perandorisë Osmane, trashëguese e drejtpërdrejt e së cilës është Turqia, autoritet turke kanë shtuar në masë të madhe përpjekjet që të rrisin përsëri ndikimin e tyre. Lidhjet kulturore, fetare por edhe historike shërbejnë aktualisht si një pikënisje në dobi të thellimit dhe nxitjes së bashkëpunimit në shumë drejtime². Pra, shtetet si Bosnjë dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria zënë tashmë një vend me rëndësi të veçantë strategjike në politikën e jashtme turke e cila këmbëngulë të zhvilloj mardhënie të mira kryesisht në fushën e diplomacisë, kulturës, fesë, tregtisë dhe ekonomisë.

Përballë vendeve të Ballkanit Perëndimor shteti turk zbaton një politikë që synon të tejkaloj problemet etnike në mënyrë që të arrihet një paqe dhe mirëbesin afatgjatë në mes të këtyre të fundit. Në këtë drejtim diplomacia turke ka kontribuar në përmirësimin e mardhënieve ndërmjet Bosnjë dhe Hercegovinës dhe Serbisë të cilat kulmuan me nënshkrimin, në vitin 2010, të "Deklaratës së Stambollit" nga të trija palët³. Për më tepër, Turqia ka qenë një nga vendet e para që ka njohur zyrtarisht pavarësinë e Kosovës dhe vazhdon të mbështesë këtë shtet të ri që të përforcoj pozitën e tij në botë, veçanërisht duke lobuar tek vendet mike që ta njohin këtë të fundit sa më shpejt që të jetë e mundur. Ankaraja mbështet gjithashtu fuqimisht hyrjen e Maqedonisë në NATO megjithë kundërshtimin e Greqisë e cila

¹ Ahmet DAVUTOGLU, « Turkey's Zero-Problems Foreign Policy », *Foreign Policy*, May 20, 2010, http://www.foreignpolicy.com/articles/2010/05/20/turkeys_zero_problems_foreign_policy?page=0,2, (konsultuar më 20 gusht 2013).

² Bedrudin BRLJAVAC, "Turkey Entering the European Union through the Balkan Doors: In the Style of a Great Power?", *Middle East Studies*, N°6, Volume 3, 2011, faqe 36.

³ ISTANBUL DECLARATION, "24 April Istanbul Trilateral Summit Declaration", *The South East European Co-operation Process (SEECP)*, Istanbul, 24 April 2010, <http://www.seecp-turkey.org/icerik.php?no=60>, (konsultuar më 20 tetor 2013).

kërkon një kompromis mbi emrin e këtij shteti¹. Në këtë mënyrë, qeveria turke nuk ngurron të luaj rolin e përfaqësuesit dhe të mbrojtësit të interesave të këtyre shteteve ballkanike kudo që të jetë e mundur nëpër instancat ndërkombëtare duke marrur kështu rolin e liderit rajonal. Këto aktivitete diplomatike nxjerrin në pah Turqinë si një akter të rëndësishëm dhe me ndikim të pa kundërshtueshëm në ruajtjen e paqës në hapësirën e Ballkanit Perëndimor. Në këtë drejtim një rol të pazëvendësueshëm luan padyshim edhe diaspora ballkanike, veçanërisht ajo shqiptare e boshnjake në Turqi. Sipas deklaratave të përfaqësuesve të lartë shtetëror, sikurse Ahmet Davutoglu, ministër i Punëve të Jashtme, në Turqi ka më shumë shqiptarë se sa në trojet shqiptare në Ballkan; në tokën turke ka më shumë boshnjakë se sa në Bosnjë dhe Hercegovinë². Këtë fakt e pohojnë edhe vlerësimet³ e ndryshme sipas të cilave në territorin turk jetojnë deri në tetë million shtetas turq me prejardhje shqiptare, ku së paku katër milion prej tyre flasin ende gjuhën shqipe⁴. Disa burime tregojnë se edhe themeluesi i Turqisë moderne Mustafa Kemal Atatürk dhe ish-presidenti Sulejman Demirel kanë origjinë shqiptare⁵. Numri i madh i qytetarëve, deputetëve në Parlamentin turk, i diplomatëve dhe nëpunësëve shtetërorë më prejardhje shqiptare ndihmon sigurisht në përforcimin e marrëdhënieve ndërmjet Turqisë dhe popullit shqiptar të shpërndarë në disa shtete ballkanike.

Meriton të përmendet edhe fakti që në disa shtete të Ballkanit sikurse në Kosovë dhe Maqedoni ka një prani të një pakice turke dhe pikërisht kjo është një arsye më shumë që Ankaraja të mbetet e interesuar që në mënyrë institucionale të mbrojë të drejtat e kësaj të fundit⁶. Këtu vërehet rëndësia e madhe që paraqet ky rajon në politikën e jashtme turke e cila është e përfaqësuar në nivel ambasadash në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Vizitat e shpeshta të zyrtarëve të lartë shtetërorë turq tregojnë gjithashtu një përkushtim të Turqisë për një prani më të madhe në këtë hapësirë. Organizimi i forumeve rajonale me karakter politik apo ekonomik, paraqet gjithashtu një përpjekje të vazhdueshme të qeverisë turke për të fituar mirëbesimin e shteteve ballkanike. Pra, duke u mbështjellur nën petkun e bashkëpunimit dhe të krijimit të urave lidhëse, autoritetet turke po bëjnë përpjekje që rikthimi i tyre në rajon të jetë sa më i lehtë. Me qëllim që të rrisin ndikimin e tyre, ato investojnë në të gjithë sektorët strategjikë si në fushën e telekomunikacionit, transportit, bankave apo edhe atë të kulturës. Lidhur me këtë të fundit, serialet televizive në gjuhën turke kanë pushtuar tashmë televizionet

¹ Sinisa Jakov MARUSIC, "Turkish Support for Macedonia's NATO Bid Riles Greece", *BalkanInsight*, May 21, 2012, <http://www.balkaninsight.com/en/article/greece-concerned-over-turkish-support-for-macedonia-at-nato>, (konsultuar më 25 shtator 2013).

² Ahmet DAVUTOGLU, « Turkey's Zero-Problems Foreign Policy », *op. cit.*

³ Duhet pasur parasysh faktin që çdoherë flitet vetëm për vlerësime për arsye se nuk ka pasur asnjëherë një regjistrim të mirëfillt të Shqiptarëve në Turqi, por edhe sikur një gjë e tillë të ndodhte, me siguri nuk do të dihej përsëri numri i saktë për shkaqe tashmë të ditura, sikurse asimilimi apo vetëdeklarimi i disave prej tyre si turq.

⁴ Dominique AUZIAS et Jean-Paul LABOURDETTE, *Albanie 2012-2013*, Paris, Nouvelles éditions de l'Université, Troisième édition, 2012, faqe 50.

⁵ Gilles de RAPPER, « Les Albanais face à leur passé ottoman : le cas de la diaspora albanaise en Turquie », in *La perception de l'héritage ottoman dans les Balkans*, sous la direction de Sylvie GANGLOFF, Paris, Éditions l'Harmattan, 2005, faqe 211.

⁶ Erhan TÜRBEDAR, « Turkey's New Activism in the Western Balkans: Ambitions and Obstacles », *Insight Turkey*, Vol. 13 / No. 3, 2011, faqe 141.

ballkanike. Ato transmetohen në orët e mbrëmjes atëherë kur shikueshmëria e tyre është më e madhe. Përveç kësaj, Agjencia turke për bashkëpunim dhe koordinim (*Türk İşbirliği ve Koordinasyon Ajansı Başkanlığı - TİKA*) mbetet tejet e pranishme përmes financimeve të saja në rindërtimin dhe meremetimin e objekteve të periudhës osmane¹. Me fjalë të tjera, kjo strategji po arrin të tërheq një numër të madh të individëve dhe në këtë mënyrë shtetet e Ballkanit Perëndimor dita ditës po bëhen më të varura ndaj pranisë turke në territoret e tyre.

3. Pengesat e ndikimit turk në shtetet e Ballkanit Perëndimor

Megjithëse Turqia ka arritur të bëhet një aktor kyç në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe ku politika e saj e bazuar në parimin « zero probleme » me fqinjët duket të ketë dhënë rezultatet më të mira, rikthimi i saj nuk është duke u mirëpritur nga të gjithë për shkak se popujt e këtij rajoni nuk e kanë fshirë nga kujtesa e tyre kohën e sundimit osman. Për këtë arsye, edhe pse Ankaraja shfaqet sot si një fuqi paqësore dhe promovuese e sigurisë në rajon, shumëkush e quan politikën e saj të jashtme si neo-osmane². Mirëpo një shprehje e tillë duket të jetë padyshim e papranueshme për autoritet turke të cilat, me qëllim që të përmirësojnë imazhin dhe të shtrijnë edhe më shumë ndikimin e tyre në rajon, kanë kërkuar që Shqiptarët të rishikojnë tekstet e lëndës së historisë për sa i përket periudhës së Perandorisë Osmane³. Kjo çështje ka qenë bisedë diskutimi gjatë vizitave të ndryshme të delegacioneve turke veçanërisht në Kosovë dhe Shqipëri, vende këto në të cilat përdoren tekste shkollore që haptazi paraqesin Osmanët si pushtues të tokave shqiptare dhe të Ballkanit në përgjithësi⁴. Përmes ndryshimit të fakteve historike, Ankaraja shpreson që rikthimi i saj në Ballkan të përceptohet më mirë nga gjeneratat e reja dhe që të kontribuoj edhe me tej drejt një përafrimi të ndërsjelltë. Edhe pse sipas qeverisë turke rishikimi i teksteve të historisë është në dobi të paqes dhe bashkëpunimit, një fjalim i tillë ngjan të ketë për qëllim përmirësimin e imazhit të Turqisë tek qytetarët e këtyre shteteve. Prandaj, këtu kemi të bëjmë pikërisht me konceptin e fuqisë së butë si një përpjekje jo e drejtpërdrejt e ndikimit.

Megjithatë, si shenjë mospajtimi ndaj kësaj nisme shumë personalitete kulturore dhe shkencore të trojeve shqiptare nënshkruan një peticion të cilin ua përcollën autoriteteve vendimëarrëse të Kosovës dhe Shqipërisë⁵. Pas kërkesës turke pati reagime të ashpra edhe nga disa personalitete politike të cilat

¹ Një prej shembujëve të shumtë është edhe restaurimi i xhamisë së Sinan Pashës në Prizren në korrik të vitit 2011. Gjatë muajit të Ramazanit përkatësisht në korrik të vitit 2013, në qendër të Prizrenit dhe Prishtinës vëreheshin gjithashtu "tenda të Iftarit" ku shprëndahej ushqim falas (sigurisht me mbështetjen financiare të shoqatave dhe autoriteteve turke).

² Tançrède JOSSERAN, *La nouvelle puissance turque. L'adieu à Mustapha Kemal*, Paris, Ellipses, 2010, faqe 42.

³ Gjergj EREBARA, " Albanians Question "Negative" View of Ottomans ", *BalkanInsight*, Tirana Albania, December 3, 2010, <http://www.balkaninsight.com/en/article/albanians-question-negative-view-of-ottomans>, (konsultuar më 18 tetor 2013).

⁴ Aleks BUDA, Kristo FRASHËRI, Hysni MYZYRI dhe të tjerët, *Historia e Popullit Shqiptar, Rilindja Kombëtare, vitet 30 të shek. XIX-1912, cituar nga Erhan TÛRBEDAR*, « Turkey's New Activism in the Western Balkans: Ambitions and Obstacles », *op. cit.*, faqe 150.

⁵ Për më shumë informacione mbi emrat e atyre që kanë nënshkruar këtë peticion shih: Portali Zëri, "Peticion kundër rishikimit të historisë nga autoritet turke", Publikuar më 27 mars 2013, <http://zeri.info/artikulli/2728/peticion-kunder-rishikimit-te-historise-nga-autoritete-turke> (konsultuar më 19 tetor 2013).

kundërshtuan hapur një kërkesë të tillë dhe nuk ngurruan të përmendin orientimin e Shqiptarëve drejt integritit në BE¹. Në të vërtetë, që prej Samitit të Selanikut (2003), e ardhmja e shteteve të Ballkanit Perëndimor është e lidhur ngushtë me integritimin evropian, rrugë për të cilën janë përcaktuar qartësisht të gjitha qeveritë e rajonit. Edhe pse një pjesë e qytetarëve të Ballkanit Perëndimor ndajnë një lloj simpatie për Turqinë, sondazhet e viteve të fundit tregojnë qartë që sidomos shtetet si Kosova dhe Shqipëria të ndjekura deri diku nga Mali i Zi, Maqedonia dhe Bosnjë-Hercegovina janë të interesuara të integrohen në BE e cila shihet si alternativa e vetme për paqe afatgjatë dhe lulëzim ekonomik². Sipas sondazheve të kryera në vitin 2011 dhe 2012 nga disa institute kërkimore ballkanike, popullariteti i BE-së në rajon duket të ketë rënë disi, pas krizës ekonomike dhe financiare të viteve të fundit, por gjithësesi përqindja e atyre që mbeshtesin proceset integruese mbetet ende e lartë³. Për më tepër, rrethanat e tanishme gjeopolitike në këtë pjesë të kontinentit evropian janë krejtësisht të ndryshme krahasuar me një shekull përpara. Ndryshe nga BE-ja, Turqia nuk ka vazhdimësi territoriale apo kufijë të përbashkët me vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe ç'është më e rëndësishmja ajo nuk ka arritur ende të përcaktoj politikën kombëtare të asnjërit prej këtyre shteteve⁴. Ndikimi i Ankarasë si fuqi ekonomike në rajon, mbetet gjithashtu ende larg nga ai i BE-së⁵. Prandaj, duket se strategjia e rikthimit të Turqisë në rajon ka hasur në disa pengesa të pakapërcyeshme. Sot për sot, shteti turk nuk është në gjendje të ofroj një projekt alternativ më tërheqës se sa procesi i integritimeve që përkrahë Brukseli tani e disa vite lidhur me të ardhmen e shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Përfundim

Ky punim kishte për qëllim që të sjellë një analizë mbi strategjinë turke përballë shteteve të Ballkanit Perëndimor të mbështetur në parimin "zero probleme" me fqinjët. Për më shumë se dhjetë vite, Turqia, në të njëjtën mënyrë sikurse edhe fuqitë e tjera emergjente, po bënë përpjekje të vazhdueshme që përmes një politike proaktive dhe gjithëpërfshirëse të luaj një rol më të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare. Ankaraja ka shtuar kështu përpjekjet për të krijuar zonën e saj të interesit duke shumëfishuar partnerët politikë dhe ekonomikë anembanë botës, por me theks të veçantë atje ku mund të ndihmojnë lidhjet me trashëgiminë osmane siç është edhe rajoni i Ballkanit Perëndimor.

Kjo analizë nxjerrë si përfundim se kryesisht nëpërmjet përdorimit të fuqisë së butë, shteti turk ka rritur ndikimin e tij në hapësirën ballkanike duke u shnëdruar në një lider me peshë të rëndësishme rajonale. Në këtë drejtim duket të kenë

¹ Bajram REXHEPI, ish-kryeministër dhe aktualisht ministër i Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, intervistë e zhvilluar më 19 tetor 2012 në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Belgjikë, Bruksel.

² GALLUP BALKAN MONITOR, "Insights and Perceptions: Voices of the Balkans", *Gallup Balkan Monitor in partnership with the European Fund for the Balkans*, 2010, faqe 22.

³ Dimitar BECHEV, "The periphery of the periphery: the Western Balkans and the euro crisis", *European Council on Foreign Relations (ECFR)*, Policy Brief, August 2012, London, p. 3, http://ecfr.eu/page/-/ECFR60_WESTERN_BALKANS_BRIEF_AW.pdf, (konsultuar më 17 shtator 2013).

⁴ Janusz BUGAJSKI, « Turkey's impact in Western Balkans », *Atlantic Council*, February 2012, faqe 5.

⁵ Inan RÜMA, « Turkish Foreign Policy towards Balkans: New Activism, Neo-Ottomanism, or/so what? », *Turkish Policy Quarterly*, Volume 9, number 4, Winter 2010, faqe 138.

kontribuar faktorë të ndryshë si lidhjet kulturore, fetare, historike, prania e një diaspore shqiptare dhe boshnjake në Turqi por edhe ajo e një komuniteti turk në disa zona të Ballkanit. Kështu që politika joshëse e doktrinës së re gjeopolitike turke ka arritur të tërheq një numër të madh të qytetarëve të cilët e shohin shtetin turk si një mik të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Megjithatë, ky studim gjithashtu vuri në pah disa pengesa të ndikimit turk në këtë hapësirë. Njëra ndër sfidat kryesore duket të jetë imazhi negativ i Turqisë të një pjesë e qytetarëve të Ballkanit Perëndimor për shkak të periudhës së sundimit osman. Për të përmirësuar pikërisht imazhin e tyre, autoritetet turke kanë ndër marrë nismën e rishikimit të teksteve shkollore duke kushtëzuar qeveritë e Kosovës dhe Shqipërisë që të punojnë në këtë drejtim. Mirëpo, pengesa tjetër kryesore për një rikthim klasik të Turqisë në rajon mbetet BE-ja. Për këtë të fundit, rajoni i Ballkanit Perëndimor paraqet një territor me rëndësi të veçantë gjeostrategjike dhe për këtë arsye që prej Samitit të Selanikut (2003), Brukseli mbështet fuqishëm, si politikisht ashtu dhe ekonomikisht, integrimin sa më të shpejtë të të gjitha shteteve ballkanike në familjen europiane. Kështu që Ballkani Perëndimor mbetet një zonë e interesit të ngushtë për BE-në e cila nuk është e interesuar të heq dorë nga kjo zonë, por përkundrazi, ndikimi i saj tejkalon shumëherë atë të Turqisë.

Burimet

AUZIAS Dominique et LABOURDETTE Jean-Paul, *Albanie 2012-2013*, Paris, Nouvelles éditions de l'Université, Troisième édition, 2012, 288 faqe.

BATTISTELLA Dario, « Chapitre 5 : L'intérêt national. Une notion, trois discours », in *Politique étrangère. Nouveaux regards*, sous la direction de Frédéric CHARILLON, Paris, Presses de Sc. Po, 2002, faqe 139-166.

BAZIN Marcel et TAPIA Stéphane de, *La Turquie. Géographie d'une puissance émergente*, Paris, Éditions Armand Colin, 2012, 335 faqe.

BECHEV Dimitar, "The periphery of the periphery: the Western Balkans and the euro crisis", *European Council on Foreign Relations (ECFR)*, Policy Brief, August 2012, London, faqe 1-16. http://ecfr.eu/page/-/ECFR60_WESTERN_BALKANS_BRIEF_AW.pdf, (konsultuar më 17 shtator 2013).

BRLJAVAC Bedrudin, "Turkey Entering the European Union through the Balkan Doors: In the Style of a Great Power?", *Middle East Studies*, N°6, Volume 3, 2011, faqe 29-44.

BUGAJSKI Janusz, « Turkey's impact in Western Balkans », *Atlantic Council*, February 2012, faqe 1-5.

DAVUTOGLU Ahmet, « Turkey's Zero-Problems Foreign Policy », *Foreign Policy*, May 20, 2010, http://www.foreignpolicy.com/articles/2010/05/20/turkeys_zero_problems_foreign_policy?page=0.2, (konsultuar më 20 gusht 2013).

EREBARA Gjergj, "Albanians Question "Negative" View of Ottomans", *BalkanInsight*, Tirana Albania, December 3, 2010, <http://www.balkaninsight.com/en/article/albanians-question-negative-view-of-ottomans>, (konsultuar më 18 tetor 2013).

GALLUP BALKAN MONITOR, "Insights and Perceptions: Voices of the Balkans", *Gallup Balkan Monitor in partnership with the European Fund for the Balkans*, 2010, faqe 1-56.

GUZZINI Stefano et RYNNING Sten, « Réalisme et analyse de la politique étrangère », in *Politique étrangère. Nouveaux regards*, sous la direction de Frédéric CHARILLON, Paris, Presses de Sc. Po, 2002, faqe 33-64.

ISTANBUL DECLARATION, "24 April Istanbul Trilateral Summit Declaration", *The South East European Co-operation Process (SEECP)*, Istanbul, 24 April 2010, <http://www.seecp-turkey.org/icerik.php?no=60>, (konsultuar më 20 tetor 2013).

JAFFRELOT Christophe, « Introduction », in *L'enjeu mondial. Les pays émergents*, sous la direction de Christophe JAFFRELOT, Paris, Presses de Sciences Po - L'Express, 2008, faqe 13-22.

JOSSERAN Tancredi, *La nouvelle puissance turque. L'adieu à Mustapha Kemal*, Paris, Ellipses, 2010, 219 faqe.

KATEB Alexandre, *Les nouvelles puissances mondiales. Pourquoi les BRIC changent le monde ?*, Paris, Ellipses Edition Marketing S.A., 2011, 267 faqe.

MARUSIC Sinisa Jakov, "Turkish Support for Macedonia's NATO Bid Riles Greece", *BalkanInsight*, May 21, 2012, <http://www.balkaninsight.com/en/article/greece-concerned-over-turkish-support-for-macedonia-at-nato>, (konsultuar më 25 shtator 2013).

MEARSHEIMER John, *The Tragedy of Great Power Politics*, London; New York, NY: W.W. Norton, 2001, 576 faqe.

NYE JR Joseph S., *The Paradox of American Power*, New York, Oxford University Press, 2002, 240 faqe.

Portali Zëri, "Petition kundër rishikimit të historisë nga autoritet turke", Publikuar më 27 mars 2013, <http://zeri.info/artikulli/2728/petition-kunder-rishikimit-te-historise-nga-autoritete-turke> (konsultuar më 19 tetor 2013).

RAPPER Gilles de, « Les Albanais face à leur passé ottoman : le cas de la diaspora albanaise en Turquie », in *La perception de l'héritage ottoman dans les Balkans*, sous la direction de Sylvie GANGLOFF, Paris, Éditions l'Harmattan, 2005, faqe 197-214.

REXHEPI Bajram, ish-kryeministër dhe aktualisht ministër i Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, intervistë e zhvilluar më 19 tetor 2012 në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Belgjikë, Bruksel.

RÛMA Inan, « Turkish Foreign Policy towards Balkans: New Activism, Neo-Ottomanism, or/so what? », *Turkish Policy Quarterly*, Volume 9, number 4, Winter 2010, faqe 134-140.

SANTANDER Sebastian, « Les puissances émergentes, l'Europe et le monde », in *Puissances émergentes : un défi pour l'Europe ?*, sous la direction de Sebastian SANTANDER, Paris, Ellipses Edition Marketing, 2012, faqe 9-22.

SANTANDER Sebastian, « Ordre mondial, hégémonie et puissances émergentes », in *L'émergence des nouvelles puissances : vers un système multipolaire?*, sous la direction de Sebastian SANTANDER, Paris, Ellipses Edition, Marketing, 2009, faqe 9-25.

TELÒ Mario, *Relations internationales : Une perspective européenne*, Bruxelles, Institut d'études européennes, Édition de l'Université de Bruxelles, Deuxième édition revue et augmentée, 2010, 240 page.

TÛRBEDAR Erhan, « Turkey's New Activism in the Western Balkans: Ambitions and Obstacles », *Insight Turkey*, Vol. 13 / No. 3, 2011, page 139-158.